

TRANKOS SH.A.
TRANKOS D.D.
TRANKOS J.S.C.

Nr.No.Br. 1/09

Dt. 27.05.2024

Fushë Kosovë - Fushë Kocovë - Kosovo Polje



trainkos

HEKURUDHAT E KOSOVËS TRANKOS SH.A.

RAPORT

Janar – Mars 2024



FUSHË KOSOVË,

Prill 2024

PËRMBAJTJA

I.	HYRJE	3
II.	STRUKTURA ORGANIZATIVE E HK-TRAINKOS SH.A.	4
III.	TREGUESIT E RAPORTIT FINANCIAR	7
III.1	Gjendja financiare janar – mars 2024	7
III.1.1	Të hyrat	7
III.1.2	Shpenzimet	8
III.2	Gjendja në para të gatshme – raporti sipas bankës më 31.03.2024	12
III.3	Transaksionet e realizuara (janar – mars 2024)	12
III.4	Bilanci i gjendjes.....	13
IV.	TRANSPORTI I UDHËTARËVE	14
IV.1	Pasqyra e performancës operative dhe financiare në TU.	14
IV.2	Numri i trenave, tren kilometër (t/km) dhe udhëtarë kilometër (u/km)	15
IV.3	Vonesat e trenave të udhëtarëve	15
V.	TRANSPORTI I MALLRAVE	16
V.1	Pasqyra e performancës operative dhe financiare në TM.....	16
V.2	Shfrytëzimi i trenave	18
V.3	Efektiviteti i trenave	19
V.4	Neto-ton & neto-ton-kilometër të transportuar	19
V.5	Revokimi i trenave	20
VI.	MIRËMBAJTJA E MJETEVE LËVIZËSE – MML	21
VI.1	Pasqyra e performancës operative	21
VII.	PROJEKTET DHE PROKURIMI.....	24
VII.1	Projektet kapitale	24
VIII.	KONTESTET LIGJORE.....	26
VIII.1	Kontestet ligjore për vitin 2024	27
IX.	AKTIVITETET NË PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESIT.....	28
IX.1	Planifikimi dhe zhvillimi i biznesit.....	28
IX.2	Aktivitetet në transportin e mallrave.....	28
IX.3	Aktivitetet në fushën promovuese.....	29
IX.4	Bashkëpunimi me hekurudhat e vendeve tjera.....	29
IX.5	Pjesëmarrja e HK-Trainkos Sh.A në iniciativat e BE-së.....	30
IX.6	Koordinimi i proceseve me ARH-në, MMPHI-në dhe institucioneve tjera relevante	30
X.	SFIDAT KRYESORE GJATË PERIUDHËS JANAR – MARS 2024 DHE VEPRIMET PËR TË ARDHMEN.....	31

I. HYRJE

Raporti për periudhën janar – mars 2024, për HK-Trainkos Sh.A. është karakterizuar kryesisht më përpjekjen e të gjitha niveleve organizative të Ndërmarrjes duke filluar nga Bordi i Drejtorëve, Menaxhmenti e deri te stafi ekzekutiv për arritjen e rezultateve më pozitive në kushtet dhe mundësitë ekzistuese.

Ky raport paraqet qartë aktivitetet gjatë këtij tremujori (janar – mars 2024) në funksion të arritjes së objektivave të vendosura me Planin e Biznesit. Po ashtu, në këtë raport pasqyrohen vështirësitë dhe sfidat gjatë zhvillimit të aktivitetit të Ndërmarrjes për këtë tremujor, sfida këto që përcillen nga periudhat paraprake e që ndikojnë drejtpërdrejt në (mos) arritjen e planifikimeve.

Sfidat për këtë periudhë kanë qenë nga më të ndryshmet, duke u përballur me të gjitha vështirësitë që vijnë nga mungesa e kërkesës në treg, veçanërisht atyre të transportit të mallrave nga shkak i mbylljes së Linjës së 10-të Hekurudhore. Mbyllja e kësaj linje ka pamundësuar zhvillimin e transportit ndërkombëtar të mallrave përmes hekurudhës gjë që ka ndikuar dukshëm edhe në transportin e brendshëm të mallrave.

Gjatë periudhës janar – mars 2024 nga transporti i mallrave janë realizuar të hyrat në shumën prej 6,004.61€, eksport/import, ndërsa nga transporti vendor nuk kemi realizuar të hyra, edhe pse ka pasur zotime nga Feronikeli.

Transporti i udhëtarëve në Linjën Prishtinë – Pejë dhe anasjelltas vazhdon të bëhet me shumë vështirësi, kjo për shkak të vjetërisë dhe gjendjes jo të mirë të mjeteve tërheqëse dhe të tërhequra.


Sa i përket transportit të udhëtarëve në Linjën Prishtinë – Shkup - Prishtinë (Maqedoni e Veriut) treni ende nuk është lëshuar në qarkullim për shkak punimeve që janë duke u zhvilluar në rehabilitimin e Linjës së 10-të Hekurudhore, Fushë Kosovë – Hani i Elezit. Kjo ndërprerje e qarkullimit do të vazhdojë deri në rehabilitimin e plotë të këtij segmenti hekurudhor.

II. STRUKTURA ORGANIZATIVE E HK – TRAINKOS SH.A.

Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A. brenda periudhës janar – mars 2024 në numrin e përgjithshëm të të punësuarve ka pasur disa ndryshime, të cilat kanë reflektuar edhe në përqindjen e strukturës së përgjithshme të të punësuarve.

Në të dhënat në vijim të këtij raporti do të pasqyrohet struktura organizative e ndërmarrjes dhe sistemimi i punëtorëve, duke filluar nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, mosha mesatare, punëtorët me kontrata në kohë të caktuar dhe të pacaktuar, lëvizjet e stafit etj.

Skema organizative:



Paraqitja statistikore për llojet e kontratave, mosha e të punësuarve, struktura gjinore, struktura nacionale dhe kualifikimi shkollor i të punësuarve në HK-Trainkos Sh.A. është si në tabelën në vijim:

Struktura e të punësuarve në bazë të kategorizimeve të HK-Trainkos Sh.A. më 1 janar 2024 dhe më 31 mars 2024				
Totali i të punësuarve	01.01.2024		31.03.2024	
	193		188	
Vlerat	Vlerat në numra		Vlerat në përqindje	
Datat	01.01.2024	31.03.2024	01.01.2024	31.03.2024
Mosha mesatare e punëtorëve	48.35	48.41	%	%
Në marrëdhënie të rregullt pune	193	188	%	%
Me kontratë në kohë të pacaktuar	52	49	26.94%	26.06 %
Me kontratë në kohë të caktuar	141	139	73 %	73.93 %
Meshkuj	167	163	86.52 %	86.70 %
Femra	26	25	13.47 %	13.29 %
Serbë	1	1	0.51 %	0.53 %
Shqiptarë	192	187	99.48 %	99.46 %
Me shkollim fillor	4	3	2.07 %	1.59 %
Me PM (përgatitje të mesme) shkollore	105	104	54.40 %	55.31 %
Kualifikim profesional	22	22	11.39 %	11.70 %
Me përgatitje të lartë	2	2	1.03 %	1.06 %
Me përgatitje superiore	60	57	31.08 %	30.31 %
Zyrtarët e Lartë	4	4	2.07 %	2.12 %
Departamenti i Transportit të Mallrave	44	41	22.79 %	21.80 %
Departamenti i Transportit të Udhëtarëve	52	54	26.94 %	28.72 %
Departamenti i Administratës	41	40	21.24 %	21.27 %
Departamenti i Financave	7	7	3.62 %	3.72 %
Departamenti i Zhvillimit të Biznesit	5	5	2.59 %	2.65 %
Departamenti i Prokurimit	4	4	2.07 %	2.12 %
Kabineti i KE-së	2	2	1.03 %	1.06 %
Zyra e Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit	14	13	7.25 %	6.91 %
Zyra për Marrëdhënie me Publikun	1	1	0.51 %	0.53 %
Zyra Ligjore	3	2	1.55 %	1.06 %
Zyra e Mirëmbajtjes së Mjeteve Lëvizëse	16	15	8.29 %	7.97 %

Format e kontratave

Gjinia

Naciona liteti.

Shkollimi

Përshtkrimi i Departamenteve

Kabineti i KE-së dhe Zyrat në kuadër të KE-së

Vërejtje: Në tabelën më lart nuk janë përfshirë anëtarët e Bordit të Drejtorëve.

Gjatë tremujorit të parë 2024, në Ndërmarrje ka pasur edhe lëvizje/ndryshime të stafit në numrin e përgjithshëm të të punësuarve. Në tabelën në vijim janë përshkruar shkaqet e lëvizjeve që kanë ndodhur/ndikuar në këto ndryshime:

Lëvizjet e të punësuarve - TM1-2024

Nr.	Emërtimi	Janar	Shkurt	Mars	
1	Aktiv në fillimmuaj	193	192	192	188
2	Të pensionuar	0	0	1	1
3	Të larguar	0	0	0	0
4	Të vdekur	0	2	0	2
5	Të dorëhequr	1	1	3	5
6	Të punësuar	0	3	0	3
7	Frekuenca në fundmuaj	193	195	192	188

Në bazë të të dhënave në tabelën më lart, shihet se numri i përgjithshëm i punëtorëve më datën 01.01.2024 ka qenë 193, ndërsa më datën 31.03.2024 ka qenë 188 punëtorë.

III. TREGUESIT E RAPORTIT FINANCIAR

1. Gjendja financiare janar – mars 2024
2. Gjendja në para të gatshme - raporti sipas bankës (31.03.2024)
3. Transaksionet e realizuara (janar – mars 2024)
4. Bilanci i Gjendjes (janar – mars 2024)

III. 1 Gjendja financiare janar – mars 2024

Për periudhën raportuese janar – mars 2024, gjendja e pozicioneve të të hyrave dhe shpenzime është siç vijon:

III.1.1. Të hyrat

Gjatë periudhës janar – mars 2024 nga **transporti i mallrave** janë realizuar të hyrat në shumën prej 6,004.61€. Totali i të hyrave të planifikuara nga transporti i mallrave për këtë periudhë raportuese ka qenë 287,500.00€, e cila është realizuar në shkallën prej 2.09%.

Të hyrat nga transporti i mallrave janë realizuar vetëm nga transporti ndërkombëtar i mallrave (nga importi 5,195.61€ dhe nga eksporti 808.99€), ndërsa nga transporti vendor i mallrave nuk kemi realizuar të hyra.

Transporti i udhëtarëve për periudhën janar – mars 2024 është realizuar në shumën totale prej 438,131.58€. Prej këtyre të hyrave, nga transporti i kontraktuar me MMPHI për OSHP janë realizuar 272,503.25€, nga të hyrat e planifikuara nga subvencioni për mbulimin e pjeshëm të humbjeve nga trenat tjerë të udhëtarëve nga ME janë realizuar 152,568.75€, ndërsa të hyrat nga biletat janë realizuar në shumën prej 13,059.58€.

Totali i të hyrave të planifikuara nga transporti i udhëtarëve për këtë periudhë raportuese ka qenë 493,318.75€, realizimi i të cilave është arritur në shkallën prej 88.81%.

Të hyrat nga shërbimet tjera gjatë periudhës janar – mars 2024 janë realizuar në shumën prej 1,500.00€. Kjo e hyrë është realizuar vetëm nga kontrata me kompaninë GCF, ndërsa nga pozicionin i të hyrave nga RIV-i dhe vendosje e vagonëve në binarë nuk kemi realizuar të hyra për këtë periudhë.

Të hyrat totale nga kjo kategori kanë qenë të planifikuara në shumën prej 4,000.00€, ndërsa realizimi i tyre është arritur në shkallën prej 37.50%.

Të hyra tjera të cilat janë realizuar gjatë periudhës janar – mars 2024, kanë arritur shumën prej 12,705.64€. Këto të hyra janë realizuar nga shitja e derivateve për HK-Infrakos Sh.A., në shumën prej 7,620.89€, të hyrat nga qiraja në shumën prej 5,084.75€, ndërsa nga pozicioni i të

hyrave nga shitjet tjera (riparimi i vagonëve të huaj) nuk kemi realizuar të hyra në këtë periudhë. Të hyrat tjera, krahasuar me planifikimin në shumën 8,500.00€, janë realizuar në shkallën prej 149.48%.

III.1.2. Shpenzimet

Shpenzimet për periudhën janar – mars 2024, ashtu edhe siç janë buxhetuar janë të klasifikuara në kategoritë që pasojnë:

Totali i kostos së shërbimit për periudhën raportuese është në shumën prej 162,248.20€. Planifikimi i këtyre shpenzimeve për TM1 ka qenë në shumën prej 316,000.00€ dhe arrin kuotën e realizimit në shkallën prej 51.34%.

Shpenzimet e stafit janë kategori tjetër e rëndësishme e cila ka arritur realizimin në shumën prej 357,076.17€. Prej këtyre shpenzimeve, 356,505.17€ kanë qenë për pagat dhe kontributet, ndërsa 571,00€ kanë qenë për kodin e kontrolleve sistematike shëndetësore. Në total, nëse e krahasojmë shumën e buxhetuar (425,000.00€) për TM1 të vitit 2024, në këtë kategori kemi arritur kuotën e realizimit në shkallën prej 84.02%.

Totali i shpenzimeve operative arrin shumën prej 17,774.63€, e cila është realizuar në shkallën prej vetëm 86.59% nga shuma e planifikuar prej 20,526.66 € për TM1-2024.

Totali i shpenzimeve administrative ka arritur në kuotën prej 112.34%, konkretisht në shumën prej 24,481.13€. Planifikimi për këto shpenzime për TM1-2024 ka qenë në shumën prej 21,791.66€.

Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – mars 2024:


Të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën Janar – Mars 2024

	EMËRTIMI	Realizimi Janar-Mars 2024	Planifikimi Janar-Mars 2024	Diferenca	B/C (%)	Realizimi Janar-Mars 2023
	A	B	C	D	E	F
A	Shitjet					
1	Transporti i mallrave	6,004.61	287,500.00	(281,495.39)	2.09	-
2	TU – Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	272,503.25	325,000.00	(52,496.75)	83.85	260,232.80
3	TU – Ministria e Ekonomisë	152,568.75	152,568.75	-	100.00	152,568.75
4	TU – Shitja e Biletave	13,059.58	15,750.00	(2,690.42)	82.92	14,367.98
5	Shërbimet tjera	1,500.00	4,000.00	(2,500.00)	37.50	1,563.56
6	Të ardhurat nga riparimi i vagonëve të huaj	-	3,500.00	(3,500.00)	-	-
7	Të hyrat tjera jo operative	12,705.64	5,000.00	7,705.64	254.11	4,918.36
I	TOTAL – TË HYRAT	458,341.83	793,318.75	(334,976.92)	57.78	433,651.45
B	Kostoja e shërbimit/blerjes së materialeve					
1	Derivatet dhe lubrifikantet	93,658.56	192,500.00	(98,841.44)	48.65	94,832.40
2	Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale	4,828.43	10,750.00	(5,921.57)	44.92	9,154.01
3	Inventar dhe pajisje	-	1,500.00	(1,500.00)	-	224.92
4	Material harxhues	-	-	-	-	-
5	Pjesë rezervë/mirëmbajtje dhe materiale tjera	10,109.09	18,750.00	(8,640.91)	53.92	833.54
6	Qasja në binarë	44,209.69	80,000.00	(35,790.31)	55.26	41,880.78
7	Sigurimi i palëve të treta	-	2,500.00	(2,500.00)	-	-
8	Tërheqja e trenave dhe qiraja e vagonëve të huaj	-	2,500.00	(2,500.00)	-	-
9	Shpenzimet e transportit - Infrakos	7,611.93	5,000.00	2,611.93	152.24	5,018.32
10	Servisimi i arkave fiskale	1,830.50	2,500.00	(669.50)	73.22	2,362.71
12	Zbritjet e lejuara	-	-	-	-	-
	TOTAL – KOSTOJA E SHËRBIMIT	162,248.20	316,000.00	(153,751.80)	51.34	154,306.68
	Fitimi (humbja) bruto	296,093.63	477,318.75	(181,225.12)	62.03	279,344.77
	TË ARDHURAT TJERA					
1	Të ardhurat e jashtëzakonshme	-	-	-	-	-
2	Të hyrat e shtyra (shpenzimet)	-	-	-	-	-
3	Të hyrat nga shitja e skrapit (shitja e aseteve)	-	-	-	-	-
4	Të ardhura tjera (shitja e skrapit-mbeturinat)	-	-	-	-	3,536.86
	TOTAL – Të ardhurat tjera	-	-	-	-	3,536.86
C	Shpenzimet e stafit					
1	Pagat dhe kontributet	356,505.17	423,750.00	(67,244.83)	84.13	399,061.99
2	Kontrollet sistematike shëndetësore, trajnime dhe shpenzime tjera	571.00	1,250.00	(679.00)	45.68	756.00

	TOTAL - Shpenzimet e stafit	357,076.17	425,000.00	(67,923.83)	84.02	399,817.99
D	Shpenzimet operative					
1	Mirëmbajtje dhe riparime	571.00	2,500.00	(1,929.00)	22.84	2,942.05
2	Shpenzimet logjistike	13,757.61	3,000.00	10,757.61	458.59	2,296.74
3	Energjia elektrike dhe komunalitë	26.08	1,750.00	(1,723.92)	1.49	2,295.54
4	Kontrollimet sistematike	-	208.33	(208.33)	-	850.00
5	Marketingu	292.14	2,600.00	(2,307.86)	11.24	1,360.11
6	Udhëtimet zyrtare	251.52	260.00	(8.48)	96.74	-
7	Telefonat dhe Posta	2,212.87	5,000.00	(2,787.13)	44.26	2,178.48
8	Shërbimet bankare	189.35	375.00	(185.65)	50.49	221.60
9	Tatimet	50.59	4,000.00	(3,949.41)	1.26	6,805.23
10	Pajisje elektronike	423.47	833.33	(409.86)	50.82	1,055.78
	TOTAL - Shpenzimet operative	17,774.63	20,526.66	(2,752.03)	86.59	20,005.53
E	Shpenzimet administrative					
1	Inventar dhe pajisje	-	1,250.00	(1,250.00)	-	-
2	Konsulenca dhe auditimi i jashtëm	600.00	1,750.00	(1,150.00)	34.29	588.98
3	Material i zyrës	2,382.31	5,125.00	(2,742.69)	46.48	3,221.08
4	Material sanitar	415.35	2,000.00	(1,584.65)	20.77	445.34
5	Qiraja për objektet	1,707.13	3,750.00	(2,042.87)	45.52	2,291.90
6	Reprezentacioni dhe bufeja	582.56	1,000.00	(417.44)	58.26	834.05
7	Shpenzimet gjyqësore dhe ndëshkimet	18,078.72	333.33	17,745.39	5,423.67	-
8	Shpenzimet logjistike	715.06	5,750.00	(5,034.94)	12.44	1,439.94
9	Kontingjente	-	833.33	(833.33)	-	-
	TOTAL - shpenzimet administrative	24,481.13	21,791.66	2,689.47	112.34	8,821.29
	Provizionimi i llogarive të arkëtueshme	-	-	-	-	-
II	TOTAL - SHPENZIMET (B+C+D+E)	561,580.13	783,318.32	(221,738.19)	71.69	582,951.49
III	Fitimi (Humbja) para zhvlerësimit	(103,238.30)	10,000.43	(113,238.73)	(1,032.34)	(145,763.18)
	GRANTET	77,488.86	102,500.00	(25,011.14)	75.60	107,085.53
F	Shpenzimet e zhvlerësimit		-			
1	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë rezultat i granteve	77,488.86	102,500.00	(25,011.14)	75.60	107,085.53
2	Shpenzimet e zhvlerësimit që janë nga buxheti i kompanisë	13,430.67	3,750.00	9,680.67	358.15	12,077.42
	TOTAL - shpenzime e zhvlerësimit	90,919.53	106,250.00	(15,330.47)	85.57	119,162.95
G	Fitimi (humbja) nga veprimtaria	(116,668.97)	6,250.43	(122,919.40)	(1,866.58)	(157,840.60)


Tabela Nr. 3.1

Pjesëmarrja e të hyrave sipas llojit të shërbimit Janar – Mars 2024



Diagrami Nr. 3.2

Pjesëmarrja e shpenzimeve sipas kategorive Janar – Mars 2024



Diagrami Nr. 3.3

III.2. Gjendja në para të gatshme – raporti sipas bankës më 31.03.2024

Nr.	EMËRTIMI	Saldo 31.03.2024
1	PCB nr. 1114-004229-0001-59	419,716.76
2	PCB (KTh) nr. 1114-004229-0101-50	0.00
3	BKK - PCB (K) nr. 1114-004229-0201-41	0.37
4	BKK - PCB (S) nr. 1114-004229-0301-32	67.68
5	BKK - PCB (M) nr. 1114-004229-0401-23	10,045.50
6	GH-PCB nr. 1114004229040114	87.52
	TOTALI	429,917.83

Tabela Nr. 3.4

III.3. Transaksionet e realizuara (janar – mars 2024)

Në tabelat në vijim janë paraqitur transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse, llogarinë e projekteve kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës dhe llogaritë rrjedhëse për subvencione:

Transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse në €	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2024	358,104.90
Inkasimet e pranuar gjatë muajve janar – mars 2024	252,073.05
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – mars 2024	190,461.19
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.03.2024	419,716.76

Tabela Nr. 3.5

Transaksionet në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës në €	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2024	0.37
Inkasimet e pranuar gjatë muajve janar – mars 2024	0.00
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – mars 2024	0.00
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.03.2024	0.37

Tabela Nr. 3.6

Transaksionet e kompanisë nga subvencionet (MMPHI dhe ME) në €	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2024	163,555.39
Inkasimet e pranuar gjatë muajve janar – mars 2024	108,633.00
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – mars 2024	262,075.21
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.03.2024	10,113.18

Tabela Nr. 3.7

Në tabelën më poshtë janë paraqitur transaksionet më të mëdha gjatë periudhës janar – mars 2024 për deponimet dhe pagesat:

Deponimet Janar-Mars 2024			Pagesat Janar-Mars 2024		
1	Të hyrat nga Transporti i Mallrave	237,431.39	1	Pagat e punëtorëve	301,115.50
2	Të hyrat nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	108,333.00	2	Pagesa e derivateve	49,664.32
3	Të hyrat nga Ministria e Ekonomisë	-	3	Pagesë për ATK	48,095.24
4	Të hyrat nga BK për Investime Kapitale	-	4	Pagesa e faturave për Infrakos Sh.A	25,713.87
5	Të hyra nga Transporti i Udhëtarëve	13,020.00	5	Pagesë borxhi për lëndën P. nr. 264/13	17,967.72
6	Deponimet tjera	1,621.66	6	Pagesat tjera	9,679.75
TOTALI		360,406.05	TOTALI		452,236.40

Tabela Nr. 3.8

III.4 Bilanci i Gjendjes (janar – mars 2024)

BILANCI I GJENDJES		
NP TRAINKOS SH.A	GJENDJA FILLESTARE 01.01.2024	GJENDJA PERFUNDIMTARE 31.03.2024
Mjetet themelore - vlera neto sipas librave	2,088,085.07	1,997,165.54
Mjetet Qarkulluese	1,402,147.39	1,427,858.13
Stoqet	412,828.61	409,221.56
Paraja	522,806.17	430,880.02
Llogaritë e arkëtueshme	443,537.80	571,552.21
Kërkesa tjera të arkëtueshme	6,549.72	6,464.72
Parapagimet	16,425.09	9,739.62
Total Mjetet Qarkulluese dhe themelore	3,490,232.46	3,425,023.67
Detyrimet afatshkurta	1,961,180.08	2,092,190.34
Llogaritë e pagueshme	640,200.53	773,091.79
Të pagueshme tjera - detyrime	874.84	637.92
Detyrime tatimore	955,141.71	953,497.63
Detyrimet e kredisë	364,963.00	364,963.00
Detyrimet afatgjata	1,459,423.18	1,381,934.77
Kapitali	5,292,179.92	5,290,118.25
Fitimi/Humbja e bartur	(4,949,586.10)	(5,222,550.72)
Fitim/ Humbja e vitit	(272,964.62)	(116,668.97)
Total detyrimet dhe kapitali	3,490,232.46	3,425,023.67

Tabela Nr. 3.9

IV. TRANSPORTI I UDHËTARËVE

IV.1 Pasqyra e performancës operative dhe financiare në TU

Gjatë periudhës janar – mars 2024 numri i përgjithshëm i udhëtarëve të transportuar është 16,802, ndërsa shuma e të hyrave nga shitja e biletave dhe ID kartelat është 13,059.58€. Krahasuar me periudhën e njëjtë raportuese të vitit 2023, numri i udhëtarëve në TM1-2024 është për 1,745 udhëtarë më pak, apo shprehur në përqindje -9.40%, ndërsa krahasuar me planifikimin, numri i udhëtarëve të transportuar është për 3,198 udhëtarë më pak, apo shprehur në përqindje, -15.99%. Ndërsa, realizimi financiar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar është për -1,150.77€ më pak, apo -8.10%, ndërsa krahasuar me planifikimin, të hyrat për këtë periudhë raportuese janë për -1,940.42€ më pak, apo -12.93 %.

Në pjesën në vijim të këtij raporti paraqesim në formë tabelore performancën operative dhe financiare në transportin e udhëtarëve për periudhën janar - mars 2024 si dhe të dhënat krahasuese me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, tremujorin paraprak si dhe planifikimin për periudhën raportuese në TM1-2024:

***Sqarim:** Në numrin total të udhëtarëve nuk janë përfshirë kategoritë e liruar nga pagesat e udhëtimit, mirëpo janë kategori të cilat frekuentojnë mjaft shumë transportin hekurudhor.*

Të dhënat për numrin e udhëtarëve							
Përshkrimi	Realizim TM1 2023	Realizim TM1 2024	Planifikim TM1 2024	Dallimi: Realizim TM1-2024-TM1-2023	Dallimi: Realizim-planifikim TM3 2023	Dallimi në %: TM1 2024-TM1 2023	Dallimi në %: Realizim-planifikim TM3 2023
Janar-Mars	18,547	16,802	20,000	-1,745	-3,198	-9.408%	-15.99%

Tabela Nr. 4.1

Të dhënat për realizimin financiar në transportin e udhëtarëve për periudhën TM1 2024							
Përshkrimi	Realizimi TM1 2023	Realizimi TM1 2024	Planifikimi TM1 2024	Dallimi: Realizim TM1 2023-TM1 2024	Dallimi: Realizim-planifikim TM1 2024	Dallimi në %: TM1 2024-TM1 2023	Dallimi në %: Realizim-planifikim TM1 2024
Janar-Mars	14,210.35	13,059.58	15,000.00	-1,150.77	-1,940.42	-8.098	-12.93

Tabela Nr. 4.2

Siç shihet nga të dhënat e paraqitura më lart, sa i përket transportit të udhëtarëve për këtë periudhë kohore kemi pasur një numër të udhëtarëve më të vogël krahasuar me vitin e kaluar por edhe në krahasim me planifikimin.

IV.2 Numri i trenave, tren kilometër (t/km) dhe udhëtarë kilometër (u/km)

Numri i trenave të udhëtarëve për këtë periudhë tremujore gjithsej ka qenë **547**, ndërsa numri i përgjithshëm i udhëtarëve për kilometër (udhëtar/kilometër) ka qenë **1,359,465**. Sa i përket totalit të kilometrave të zhvilluara nga të gjithë trenat e transportit të udhëtarëve (tren/km) ka qenë **34,044.00**.

IV.3 Vonesat e trenave të udhëtarëve

Gjatë kësaj periudhe raportuese ka pasur edhe vonesa të trenave, të cilat janë pasqyruar në tabelën në vijim:

Shkaku i vonesave	Minuta	Në përqindje (%)
Lokomotiva HM	0	0
Vazhdimi i udhëtimit	0	0
Kryqëzimet	0	0
Lokomotiva/GM defekt	0	0
Lidhja me trenin	0	0
Bashkëngjitja e vagonëve/tërheqja e mjeteve	0	0
Doganë + Polici	0	0
Pritje në garniturë	0	0
Aksidente	3	0
Në nisje	223	32,41
Në arritje	465	67,59
Të tjera	0	0
Total vonesat	688	100

Tabela Nr. 4.3

V. TRANSPORTI I MALLRAVE

V.1 Pasqyra e performances operative dhe financiare në TM

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim indikatorët fizikë të performancës operative në transportin e mallrave për periudhën janar – mars 2024 si dhe do të behët krahasimi me planifikimin dhe me realizimin për periudhën e njëjtë të vitit 2023.

Gjatë periudhës janar - mars 2024 janë transportuar 1,274.66 neto-tonë mallra, ndërsa shuma e të hyrave nga ky transport ka qenë 6,004.61€. Krahasuar me periudhën e njëjtë raportuese të vitit 2023, në TM-1 2024 realizimi në neto-tonë mallra është për 100% më i lartë, pasi që në vitin e kaluar nuk ka pasur fare transport në këtë periudhë. Mirëpo, nëse krahasojmë realizimin me planifikimin për TM1 2024, janë 118,725.34 neto-tonë mallra më pak të transportuara, apo shprehur në përqindje, është realizuar vetëm 1.06% e planifikimit. Ndërsa, realizimi financiar krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar është për 6,004.61€ më shumë, apo shprehur në përqindje, të hyrat janë më të larta për 100%, ndërsa krahasuar me planifikimin, të hyrat për këtë periudhë raportuese janë për -279,210.78€ më pak, apo është realizuar vetëm 2.17% e planifikimit.

Në pjesën në vijim të këtij raporti paraqesim në formë tabelore dhe përmes diagrameve performancën operative dhe financiare në transportin e mallrave për periudhën janar - mars 2024 si dhe të dhënat krahasuese me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar si dhe me planifikimin për periudhën raportuese në TM1 2024.

Realizimi në transportin e mallrave:

Janar- Mars 2024	Realizimi Neto Ton 2023	Realizimi Neto Ton 2024	Planifikimi Neto Ton 2024	Dallimi Realizim 2024/2023	Dallimi Realizim-Planifikim 2024	Dallimi Realizim 2024/2023 (%)	Dallimi Realizim-Planifikim 2024 (%)
Sasia e transportuar	0.00	1,274.66	120,000	1,274.66	-118,725.34	100%	1.06%

Tabela 5.1

Siç mund të shihet nga tabela 5.1, transporti është realizuar në shkallën prej 1.06 % të planifikimit, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, dallimi është në shkallën 100%.

Transporti i mallrave me kontejnerë për periudhën janar – mars 2024 ka qenë:

Numri i transportuar i kontejnerëve	Kontejnerë të plotë 2024	Kontejnerë të zbrazët 2024
Sasia	0.00	0.00

Tabela 5.2

Sasia e transportuar në neto-ton për periudhën Janar - Mars 2024 në formë diagrami:




Figura 5.1

Siç mund të shihet nga figura 5.1 në aspektin operativ nuk kemi arritur të realizojmë në tërësi transportin e planifikuar për periudhën janar – mars 2024.

Të hyrat nga transporti i mallrave për periudhën raportuese janë:

Të hyrat Janar-Mars 2024	Realizim shitje të hyra 2023	Realizim shitje të hyra 2024	Planifikim 2024	Dallimi në Realizim 2024/2023	Realizim-Planifikim 2024	Realizim 2024/2023 (%)	Realizim-Planifikim 2024 (%)
Vlera €	0.00	6,004.61	276,000.00	6,004.61	-269,995.39	100%	2.17%

Tabela 5.3

Siç mund të shihet nga tabela më lart, të hyrat janë më të ulëta se sa planifikimi për 97.83%, ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, këtë vit realizimi ka qenë për 100% më shumë krahasuar me periudhën e njëjte të vitit 2023.

Të hyrat në periudhën Janar – Mars 2024 në formë diagrami:




Figura 5.2

Të hyrat dhe shpenzimet nga transporti i mallrave:

Të hyrat dhe shpenzimet	Shitjet/të hyrat në TM	Të ardhura tjera nga TM	Total shitjet	Shpenzi met direkte në TM	Shpenzi met indirekte në TM	Total Shpenzimet	Fitimi/hu mbja operative	Fitim i/hu mbja në %
Vlera €	6,004.61	1,500	7,504.61	89,738.87	21,456.61	111,195.48	(103,690.87)	6.74

Tabela 5.4

Transporti i mallrave në kostot indirekte ka marrë pjesë me 19.29% në shpenzimet e përgjithshme të Ndërmarrjes, kjo vjen nga ndarja e shpenzimeve mes transportit të udhëtarëve në bazë të përqindjes së pjesëmarrjes së trenave (*tren kilometër*) në komunikacion.

V.2 Shfrytëzimi i trenave

Për shkak të punimeve në Linjën e 10-të Hekurudhore, në relacionin Fushë Kosovë - Hani i Elezit, linja ka qenë e mbyllur gjatë gjithë kohës, me përjashtim në fillim të muajt janar (09.01.2024 deri më 17.01.2024), ku është transportuar një (1) tren në import dhe një (1) tren në eksport. Ndërsa, transporti vendor nuk është realizuar sipas planifikimeve, për shkak të mos fillimit të transportit të xehes nga Ferronikeli.

Janar – Mars 2024	Trena të planifikuar	Trena të shfrytëzuar	Shfrytëzim/Planifikim në % 2024
Import	0	1	100%
Export	0	1	100%
Vendor	228	0	0.00%
Total	228	2	0.87%

Tabela 5.5

V.3 Efektiviteti i trenave

Janar – Mars 2024	Pesha max. bartëse t/tren	Mesatarja e çdo treni - bt	Efektiviteti (%)
Import	1200	731	60.91%
Eksport	1200	336	28.00%
Vendor	1400	0.00	0.00 %

Tabela 5.6

V.4 Neto-ton & neto-ton kilometër të transportuar

Neto ton	Realizim Janar-Mars 2024	Planifikim Janar-Mars 2024	Realizim/Planifikim 2024 në %	Neto ton kilometër	Humbje Planifikim/Realizim 2024 (ton)
Import	765.86	0.00	100 %	46,104.77	765.86
Export	508.80	0.00	100 %	30,629.76	508.80
Vendor	0	120,000	0.00%	0.00	-120000
Total	1,274.66	120,000	1.06%	76,734.53	-118,725.34

Tabela 5.7

Organizimi i tërheqjes me lokomotiva dhe manovruese – shpenzimet e naftës dhe kilometrat e kaluara:

Shpenzimet e lokomotivave tërheqëse dhe manovruese -Transporti i mallrave Janar-Mars 2024							
Muaji	Shp/km	26400007	26400008	2640010	26200016	26600001	Totali
Janar	Shp.Naftë	1,800.00	1,300	0,00	0,00	0,00	3,100.00
	Kilometrat	850	383	0,00	0,00	25	1,213
	Nafta /km	2,236	3,39	0,00	0,00	0,00	2,555
Shkurt	Shp.Naftë	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
	Kilometrat	211	18	0,00	0,00	0,00	229
	Nafta /km	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00	0,00
Mars	Shp.Naftë	4,030	0,00	0,00	0,00	0,00	4,030
	Kilometrat	1,468	196	0,00	0,00	0,00	1,664
	Nafta /km	2,745	0,00	0,00	0,00	0,00	2,425
Janar – Mars 2024	Shp.Naftë	5,830	1,300	0,00	0,00	0,00	7,130
	Kilometrat	2,484	597	0,00	0,00	0,00	3,081
	Nafta /km	2,347	2,177	0,00	0,00	25	2,314

Tabela 5.8

V.5 Revokimi i trenave

Gjatë periudhës janar – mars 2024 ka pasur disa revokime të trenave të planifikuar, të cilat pasqyrohen në tabelën në vijim sipas kategorive të ndara në transportin ndërkombëtar (import-export) dhe transport vendor:

Janar Mars 2024	Trena të revokuar me 0%	Trena të revokuar me 10%	Trena të revokuar me 20%	Trena të revokuar me 100%	Vlera në euro e revokimeve
Import-Export	78	0	0	0	0.00 €
Vendor	0	228	0	0	0.00 €
Total	78	228	0	0	999.78 €

Tabela 5.9

Në tabelën më lart shihet se gjatë periudhës janar – mars 2024 në import dhe eksport janë revokuar në total 78 trena me 0%, të planifikuar sipas OLT;

Ndërsa në transportin vendor gjatë periudhës janar – mars 2024 në total janë 228 trena të revokuar me 10%, vlera e revokimeve është 999.78€.

Revokimet e këtyre trenave në transport vendor kanë ardhur si pasojë e mos fillimit të transportit të planifikuar nga NewCo Ferronikeli.

VI. MIRËMBAJTJA E MJETEVE LËVIZËSE – MML

VI.1 Pasqyra e performancës operative

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim performancën në mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse gjatë periudhës janar – mars 2024 si dhe krahasimet me realizimin e periudhës së njëjtë të vitit 2023.

VI.2 Sektori i mirëmbajtjes

Në Zyrën e Mirëmbajtjes së Mjeteve Lëvizëse përfshihen: Mirëmbajtja e trenave motorikë, mirëmbajtja e lokomotivave transportuese, mirëmbajtja e lokomotivave manovruese, mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtarëve, mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave dhe punë të tjera për riparimin e vagonëve të huaj.

VI.2.1 Mirëmbajtja e trenave motorikë

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e trenave motorikë të realizuara në periudhën janar – mars 2024 krahasuar me periudhën janar – mars 2023:

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	Janar - Mars 2024	Janar - Mars 2023	Ndryshimi
1.	Servisime	0	0	0
2.	Riparime	0	0	0
3.	Kontrollime K1	0	0	0
4.	Kontrollime K6	0	0	0

Tabela 6.1

VI.2.2 Mirëmbajtja e lokomotivave transportuese

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e lokomotivave transportuese të realizuara në periudhën janar – mars 2024 krahasuar me periudhën janar – mars 2023:

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	Janar - Mars 2024	Janar - Mars 2023	Ndryshimi
1.	Servisime	84	60	+24
2.	Riparime	14	9	+5
3.	Kontrollime K1	4	4	0
4.	Kontrollime K3	1	0	+1
5.	Kontrollime K6	0	3	-3
6.	Gdhendja e rrotave	0	0	0

Tabela 6.2

VI.2.3 Mirëmbajtja e lokomotivave manovruese

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e servisimeve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e lokomotivave manovruese të realizuara në periudhën janar – mars 2024 krahasuar me periudhën janar – mars 2023:

	Lloji i Riparimit/Mirëmbajtjes	Janar - Mars 2024	Janar - Mars 2023	Ndryshimi
1.	Servisime	0	1	-1
2.	Riparime	1	4	-3
3.	Kontrollime K1	0	2	-2
4.	Kontrollime K3	0	0	0
5.	Kontrollime K6	0	1	-1

Tabela 6.3

VI.2.4 Intervenimet në mjetet tërheqëse

Intervenimet në mjetet tërheqëse gjatë periudhës tre mujore (janar – mars 2024) për secilin mjet tërheqës është dhënë në tabelën në vazhdim:

Mjetet tërheqëse (Nr.)	2620 005	2640 007	2640 008	2710 009	2640 010	2620 016	2760 001	2760 002	5800 004
Servisime (S)	0	6	5	0	0	73	0	0	0
Riparime (R)	3	2	1	0	0	8	1	0	0
Kontrollime (K 1)	0	1	1	0	0	2	0	0	0
Kontrollime (K 3)	0	0	0	0	0	1	0	0	0
Kontrollime (K 6)	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gdhendje të rrotave	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Tabela 6.4

Servisime – S

Riparime – R

Kontrollime njëmuajor – K1

Kontrollime tremujor – K3

Kontrollime gjashtëmuajor – K6

VI.2.5 Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e udhëtarëve

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testimeve të komponentëve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e vagonëve të udhëtarëve realizuar në periudhën janar – mars 2024, krahasuar me periudhën janar – mars 2023:

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	Janar - Mars 2024	Janar - Mars 2023	Ndryshimi
1.	Kontrollime (K1)	16	18	-2
2.	Riparim në punëtori	23	14	+9
3.	Gdhendje të rrotave	7	5	+2
4.	Testim i komponentëve	0	0	0

Tabela 6.5

IV.2.6 Mirëmbajtja e vagonëve për transportin e mallrave

Në vazhdim është dhënë pasqyra numerike e testimeve të komponentëve, kontrollimeve dhe riparimeve për mirëmbajtjen e vagonëve të mallrave të realizuar në periudhën janar – mars 2024, krahasuar me periudhën janar – mars 2023:

	Lloji i riparimit/mirëmbajtjes	Janar - Mars 2024	Janar - Mars 2023	Ndryshimi
1.	Kontrollime K3	0	0	0
2.	Riparim në punëtori	0	0	0
3.	Riparim në teren	0	0	0
4.	Gdhendje të rrotave	0	0	0

Tabela 6.6

VI.2.7 Riparimi i vagonëve të huaj

Gjatë këtij tre mujori, Zyra e Mirëmbajtjes së Mjeteve Lëvizëse nuk ka pasur kërkesa për riparim të vagonëve të huaj:

Riparimi/mirëmbajtja e vagonëve të huaj	Janar - Mars 2024	Janar - Mars 2023
NewCo Ferronikeli	00.00 €	00.00 €

Tabela 6.7

VII. PROJEKTET DHE PROKURIMI

VII.1 Projektet kapitale për periudhën Janar – Mars 2024

Në tabelën 7.1 janë paraqitur projektet të cilat janë zhvilluar gjatë periudhës janar - mars 2024:

Nr	Titulli i Aktivitetit të Prokurimit	Data e nënshkrimit	Vlera e parashikuar	Vlera e kontratës	Koment
1	Riparimi i PG Rregullatorit të lokomotivës GT22HW-2 (645)	06.01.2024	9,000.00	8,810.00	Përfunduar
2	Shërbimet e abonimit të arkave fiskale	06.02.2024	4,319.98	4,319.98	Në zbatim
3	Shërbimet e Auditimit të Pasqyrave Financiare për vitin 2023, 2024, 2025	20.12.2023	9,500.00	7,839.97	Në zbatim
4	Furnizimi me material hixhienik	19.03.2024	2,599.00	1,433.63	Në zbatim
5	Furnizimi me vajra dhe lubrifikante	08.03.2024	30,000.00	3.16	Në zbatim
6	Riparimi i pajisjeve dhe mjeteve lëvizëse hekurudhore	29.09.2023	130,000.00	129,497.72	Përfunduar
7	Shërbimet e sigurimit të palëve të treta	17.04.2024	2,000.00	1,996.56	Në zbatim

1. Riparimi i PG Rregullatorit të lokomotivës GT22HW-2 (645) është projekt i tenderuar i cili është paraparë të financohet përmes mjeteve të dedikuara për projekte kapitale. Projekti ka përfunduar sipas kërkesave të njësisë kërkuese.

2. Shërbimet e abonimit të arkave fiskale është projekt i kontraktuar si kontratë kornizë dhe është në zbatim.

3. Shërbimet e Auditimit të Pasqyrave Financiare për vitin 2023, 2024, 2025 janë kontraktuar me vlerë të ofertës prej **7,839.97€**. Projekti është kontraktuar për periudhën trevjeçare dhe është në zbatim e sipër.

4. Furnizimi me material higjienik është projekt për të cilin është konstatuar nga komisioni i vlerësimit se ka oferta të përgjegjshme. Kontrata është nënshkruar me operatorin ekonomik me ofertën e përgjegjshme dhe çmimin më të lirë. Është caktuar projekt menaxheri dhe kontrata është në zbatim e sipër.

5. Furnizimi me vajra dhe lubrifikante është projekt i cili është tenderuar në bazë të sasive të kërkuara nga njësi kërkuese. Kontrata është lidhur me çmime njësi e cila do të përfundon me realizimin e buxhetit të alokuar prej 30,000.00€ sikurse në deklaratën e nevojave dhe disponueshmerisë së fondeve.

6. Riparimi i pajisjeve dhe mjeteve lëvizëse hekurudhore. Ky projekt është në përputhje me marrëveshjen për projekte kapitale e kemi ritenderuar Riparimi i pajisjeve dhe mjeteve lëvizëse hekurudhore – Ndërrimi i rrotave në karretat e lokomotivës. Projekti është kontraktuar dhe është pranuar edhe nga komisioni i pranimit teknik. Vlen të theksohet se projekti ka përfunduar me vonesa dhe se në përfundim do të aplikohen dënimet prej 10% të totalit të kontratës në përputhje me kushtet e kontratës.

7. Shërbimet e sigurimit të palëve të treta. Projekti për shërbime të sigurimit të palëve të treta është hapur dhe janë pranuar dy oferta. Komisioni ka rekomanduar shpërblimin me kontratë të operatorit me çmimin më të lirë dhe ofertën e përgjegjshme. Shërbimet janë kontraktuar dhe kontrata do të fillon më datën 05.05.2024 kur edhe skadon sigurimi i mëparshëm.

VIII. KONTESTET LIGJORE

Gjatë periudhës kohore janar – mars 2024, nga Zyra Ligjore e Ndërmarrjes janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për përfaqësim sa më të mirë në çështjet ligjore pranë të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës. Në tabelën më poshtë do të paraqesim seancat e mbajtura, veprimet që janë ndërmarrë në cilësinë e paditësit, të paditurit, kreditorit dhe debitorit, si dhe aktvendimet dhe aktgjykimet e gjykatave.

	Përshkrim	Vlera në €
1.	Gjatë këtyre muajve janë mbajtur 3 seanca: C.nr.4657/19, C.nr.609/21, C.nr.4657/19 dhe kemi pranuar 5 thirrje për seanca.	
2.	Me datë 10.01.2024 nga Av. Emrush Kastrati është pranuar Propozim për përbarimin e aktgjykimit të plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm, te Përmbaruesi Privat Isa Shala, në lëndën P.nr.02/24 kreditor NTSH “Etika”. Me datë 08.02.2024 nga Përmbaruesi Privat Isa Shala është pranuar Ekspertizë Financiare nga Avni Aruqi, Ekspert Gjyqësor Financiar, në lëndën përbarimore P.nr.02/2024, paditës N.T.SH. “Etika”, e paditur HK-Trainkos Sh.A. Për këtë lëndë është dërguar dhe pranuar e-mail nga përmbaruesi privat Isa Shala në lidhje me borxhin bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, ku është kërkuar t’i veçojë sipas të dhënave bashkangjitur me thirrjen ligjore, me qellim të procedimit tutje drejt ekzekutimin në Zyrën e Financave në respektim dhe përmbushje të ligjit.	30,553.78
3.	Me datë 19.01.2023 është dërguar e-mail te Përmbaruesi Privat Esat Murati ku është kërkuar të na njoftojë nëse ka ndërmarr ndonjë veprim në lidhje me lëndën P.nr.315/23 të H.K, pas kthimit të fletëpagesës të pranuar nga ana e tyre. Pas kësaj, nga Përmbaruesi kemi pranuar njoftim se me datë 18.01.2024 janë bllokuar llogaritë e Debitorit.	2,010.00
4.	Me datë 30.01.2024 është pranuar Aktgjykim nga Gjykata e Apelit në Prishtinë, në lëndën kontest pune Ac.nr.1267/2020, paditëse N. D., e paditur HK-Trainkos Sh.A. në të cilin Aktgjykim është refuzuar e pathemeltë ankesa e të paditurës HK-Trainkos Sh.A., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.1969/18 i datës 03.09.2019, vërtetohet. Pas pranimit të këtij Aktgjykimi, më 29.02.2024 kem dërguar në Gjykatën e Apelit të Kosovës për Gjykatën Supreme të Kosovës – Revizion për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me datë 08.03.2024 nga Përmbaruesi Privat Fadil Hoxha është pranuar Propozim për Përbarim në lëndën kontest pune P.nr.54/2024, vlera e kontestit: 71,290.52 € paditëse N.D., e paditur HK-Trainkos Sh.A. Pas pranimit të këtij Propozimi për Përbarim, më 14.03.2024 në Gjykatën Themelore në Prishtinë për Përmbaruesin Privat Fadil Hoxha, është dërguar Prapësim kundër urdhrit përbarimor P.nr.54/2024 të datës 27.02.2024 nr.151/24, të sjellë nga ana e Përmbaruesit Privat, i pranuar nga debitori me	71,290.52

	datë 08.03.2024, me nr. Protokolli 168/17.	
5.	Me datë 30.01.2024 është pranuar Aktgjykimi nga Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, në lëndën kontest pune C.nr.2425/19, paditës J.H., e paditur HK-Trainkos Sh.A., në të cilin Aktgjykim është refuzuar në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit J.H.	1,435.40
6.	Me datë 13.02.2024 nga Gjykata Themelore në Prishtinë është pranuar Aktvendim në lëndën kompensim dëmi C.nr.1377/13, paditëse HK-Trainkos Sh.A, i paditur A.I., tani me adresë të panjohur, ku i është caktuar përfaqësuesi i përkohshëm në këtë çështje juridike kontestimore. Së bashku me këtë Aktvendim është pranuar edhe njoftimi që përfaqësuesi i përkohshëm të shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe, për çka obligohemi që ta përkthejmë Aktvendimin C.nr.1377/13 të datës 07.02.2024 në gjuhën angleze dhe serbe nga përkthyes të licencuar gjuhësor dhe brenda 15 ditësh, sipas tyre, të procedojnë tutje. Me datë 23.02.2024 në Gjykatën Themelore në Prishtinë është dërguar përkthimi gjyqësor i kërkuar në gjuhën serbe dhe angleze, për të cilin në bazë të aktvendimit, Gjykata brenda afatit prej 7 ditësh do të jap shpalljen, e cila do të botohet në gazetën zyrtare dhe publikohet në tabelën e shpalljeve të kësaj Gjykate.	2,455.00
7.	Shpenzime për përkthim të Aktvendimit C.nr.1377/13 në gjuhën serbe dhe angleze kanë qenë 94.40 € dhe shpenzime tjera gjyqësore 31.00 €.	125.40

Tabela 8.1

VIII.2. Kontestet gjyqësore për vitin 2024

Hekurudhat e Kosovës-Trainkos Sh.A. gjatë vitit 2024, pritet të ballafaqohen me **59** konteste gjyqësore. Në tabelën më poshtë është pasqyruar numri i kontesteve dhe kategorizimi i tyre për të cilat mund të zhvillohen veprime procedurale dhe mund të përfundohen gjatë vitit 2024:

Nr.	LLOJET E KONTESTEVE	////////
1.	Kontestet e marrëdhënies së punës	9
2.	Kontestet për kompensim të dëmit	26
3.	Kontestet për pagimin e borxhit	4
4.	Kontest nga Konflikti Administrativ	1
5.	Lëndë në procedurë përmbartimore	19
6.	Lëndë në procedurë penale	
	Totali	59

Tabela 8.2

IX. AKTIVITETET NË PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN E BIZNESIT

IX.1 Planifikimi dhe zhvillimi i biznesit

Me qëllim të arritjes së objektivave të planifikuara dhe të synimeve të vazhdueshme në përputhje me misionin dhe vizionin, Ndërmarrja është duke u angazhuar në vazhdimësi në realizimin e këtyre qëllimeve. Mirëpo, përkundër përpjekjeve dhe angazhimeve, janë faktorë tjerë, të jashtëm, që kanë ndikuar dhe janë bërë pengesa në zhvillimin dhe realizimet e planifikuara. Një prej shkaqeve më kryesore në këto pengesa është edhe ndërprerja e transportit për shkak të punimeve që janë duke u zhvilluar në Linjën e 10-të Hekurudhore si lidhja e vetme ndërkombëtare si dhe nga mos fillimi i transportit nga ana e partnerit strategjik NewCo Ferronikeli. Përveç pengesave në transport, ato janë shfaqur edhe në realizimin e projekteve tjera.

Në pjesën në vijim të këtij raporti do të prezantohen edhe disa të dhëna rreth aktiviteteve të ndërmarrjes, për periudhën janar – mars 2024, të cilat janë të ndërlidhura me Departamentin e Zhvillimit të Biznesit, i cili është përgjegjës edhe për zhvillimin e biznesit të Ndërmarrjes, duke filluar nga marketingu dhe shitja e deri tek planifikimi strategjik, zhvillimi i politikave të aprovuara dhe koordinimi me faktorët relevant.

IX.2 Aktivitetet në transportin e mallrave

Nga klientët vendorë, me të cilët kemi pasur të nënshkruar aneks kontratë për transport deri më 31.12.2023 ka qenë vetëm një, me të cilin pritet që të vazhdohet kontrata edhe në vitin 2024:

Klient vendor:

Nr.	Emri i kompanisë	Vendi	Mallrat që transporton
1	NewCo Ferronikeli	Drenas	Xehe të nikelit dhe thëngjill.

Klientët/partnerët ndërkombëtarë, me të cilët kemi nënshkruar kontratë transporti për vitin 2024 janë gjithsej tre (3). Me këta partnerë kemi pasur kontratë transporti edhe në vitin 2023.

Lista e partnerëve ndërkombëtarë:

Nr	Emri i kompanisë	Vendi	Mallrat që transporton
1	NAVICO SHIPPING DOO	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet
2	CARGO LOGISTC DOO	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet
3	ARGO LOGISTIC INT	Shkup - Maqedoni	Të gjitha llojet

Klienti/partneri **Shcenger DB** nuk e ka nënshkruar kontratën për vitin 2024 për shkak të pamundësisë së transportit të mallrave për arsye të mbylljes së linjës 10-të hekurudhore. Ndërsa,

klienti **Fershped AD** nuk ka paguar garancionin bankar për shkak se nuk ka informatë të saktë për hapjen e linjës 10-të nga Infrakos Sh.A dhe kontrata e tij sipas Rregullores së TM-së nuk është e vlefshme deri në pagesën e garancionit. Fershped AD ka pranuar që pagesat e transportit t'i realizojë në avancë në rast se do të këtë ndonjë transport gjatë vitit 2024.

IX.3 Aktivitetet në fushën promovuese

Promovimi i shërbimeve të HK-Trainkos Sh.A është zhvilluar përmes kanaleve të ndryshme të marketingut. Edhe gjatë kësaj periudhe është vazhduar me promovimin e shërbimeve në rrjetet sociale si Facebook, Instagram, LinkedIn, Google Bussines Profile dhe ViberCommunity dhe në faqen zyrtare të HK-Trainkos Sh.A. Po ashtu, përmes këtyre rrjeteve/mundësive janë mbajtur kontakte si me udhëtarë aktualë ashtu edhe me ata potencialë. Janë mundësuar udhëtime me tren të grupeve të organizuara dhe janë venë në shërbim asetet e Ndërmarrjes në bazë të kërkesave të miratuara paraprakisht.

Kërkesat për shfrytëzim të aseteve, shërbimeve të veçanta gjatë periudhës janar – mars 2024 janë si në vijim:

Data e shfrytëzimit	Institucioni	Lloji i Shfrytëzimit
21.02.2024	IAAP FAN S Noli	Transporti i nxënësve
28.02.2024	Fotograf – Freelancer	Ekspozitë
02.03.2024	SH.F.M.U Selman Riza	Transporti i nxënësve
28.03.2024	Koperativa Agency	Vagonë të udhëtarëve
28.03.2024	Produksion	Xhirime dhe fotografi

IX.4 Bashkëpunimi me hekurudhat e vendeve tjera

Viti 2024 karakterizohet me datat premtuese për përfundimin e punëve në Modernizimin e Linjës së 10-të hekurudhore (Sesioni 1, Fushë Kosovë – Han i Elezit dhe Sesionit 2, Fushë Kosovë – Mitrovicë). Kjo dinamikë e punëve na pamundëson realizimin e transportit sipas kërkesave dhe potencialit të mundshëm.

Punët në realizimin e projektit “Studimi i fizibilitetit për Linjën hekurudhore që lidhë Shqipërinë me Kosovën” janë në vllug dhe karakterizohen me vendimet e marra nga shteti i Shqipërisë për trasenë e mundshme që do të krijojë potencial për revolucion në transportin me hekurudhë në dhe nga Kosova. Shfrytëzimi i porteve detare nga Adriatiku (Vlora, Durrësi, Shëngjini dhe Tivari) jep sinjale pozitive në realizimin e idesë tanimë të shndërruar në projekt të “Portit të Thatë” në Fushë Kosovë. Kjo krijon potencial për transport me hekurudhë (mallra dhe udhëtarë) e që ndërlihdë vendin tonë me Shqipërinë dhe botën.

Sfidë dhe detyrë e Ndërmarrjes sonë është nxënia e hapit me këto zhvillime, furnizimi i flotës së mjeteve lëvizëse sipas standardeve të kërkuara dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore për realizimin e transportit potencial.

Kontaktet janë mbajtur edhe me Hekurudhat e Maqedonisë së Veriut me qëllim të bashkërendimit të punëve dhe aktiviteteve në transportin ndërkombëtar. Aktualisht, e vetmja linjë e hapur ndërkombëtare është ajo përmes Maqedonisë së Veriut.

IX.5 Pjesëmarrja në iniciativat e BE-së për reforma në transportin hekurudhor përmes Lëvizshmërisë së Qëndrueshme

Aktivitetet e ngjeshura në realizimin e objektivave të përcaktuara nga BE dhe të konfirmuara me Traktatin për Transport e që definojnë rrugëtimin për një Lëvizshmëri të Qëndrueshme kanë vazhduar edhe në vitin 2024.

Me konfirmimin e koncept dokumentin për ndryshimin e legjislacioni për hekurudha dhe siguri janë dhënë detyrat për krijimin e grupeve punuese në hartimin e Ligjit të ri për Hekurudha dhe Ligjit për Siguri dhe Ndërveprueshmëri. Dinamika e përcaktuar nga përgjegjësit në MMPHI është që i gjithë procesi të përfundoj brenda këtij viti.

Strategjia Inteligjente për Transport (SIT) 2024 – 2030 është nënshkruar nga Kryeministri dhe është në proces puna në finalizimin e “Planit të Veprimit për realizimin e Strategjisë SIT 2024 – 2026”.

Në Vjenë të Austrisë është mbajtur takimi i 19-të, i radhës, i Komitetit Teknik për Hekurudha (26-27 Shkurt 2024), teknikisht është punuar në Draftin e Planit të Veprimit 2024 – 2027 dhe koordinimin e mundësive që ofrohen nga potenciali i mundshëm nga entitetet, asociacionet dhe shtetet e Evropës.

IX.6 Koordinimi i proceseve me ARH-në, MMPHI-në dhe institucioneve tjera relevante për proceset që ndërlidhen me këto entitete

Angazhimi në plotësimin e obligimeve në raport me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), Sekretariatit, ARH-në, Ministrinë e Ekonomisë (ME), ASK (Agjencinë e Statistikave të Kosovës) dhe KHAIA është i vazhdueshëm. Ndër aktivitetet më të reja vlen të veçohen:

- Vazhdon pjesëmarrja aktive përmes përfaqësimit në hartimin e Ligjit për Hekurudha dhe Ligjit për Siguri dhe Ndërveprueshmëri, kjo nën udhëheqjen e MMPHI-së dhe
- Pjesëmarrja aktive si përfaqësimit në grupin punues me MMPHI-në për punimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë SIT 2024 – 2026;
- Kemi mbajtur takim të nivelit të lartë me ARH-në për temat si çështjet e bashkëpunimit mes Trainkos dhe ARH-së, procesi i riparimit të vagonëve të udhëtarëve, procesi i aplikimit të tërheqjes së ML të Trainkosit nga regjistri NVR, siguria e përgjithshme gjatë transportit hekurudhor.

X. SFIDAT KRYESORE GJATË PERIUDHËS JANAR – MARS 2024 DHE VEPRIMET PËR TË ARDHMEN

HK-Trainkos Sh.A edhe nga fillimi 2024 është ballafaquar me vështirësi dhe sfida, të cilat e kanë përcjellë edhe gjatë kësaj periudhe raportuese, janar – mars 2024. Prej këtyre sfidave, ndër më kryesoret, kemi veçuar ato si në vijim:

1. Ballafaqimi në vazhdimësi me ndërprerje të linjës Fushë Kosovë – Hani i Elezit gjatë Modernizimit të këtij sesioni për shkak të vonesave në realizimin e projektit “Modernizimi i Linjës së 10-të hekurudhore”;
2. Mjete lëvizëse hekurudhore të pakta në numër dhe jo në gjendje të mirë për shkak të vjetërsisë së tyre. Transporti i udhëtarëve zhvillohet me trena klasike, në vend të trenave të lehtë (garnitura motorike) të cilët janë shumë më ekonomik;
3. Mungesë e mjeteve financiare për ripërtëritje të mjeteve lëvizëse për plotësimin e nevojave në transport të udhëtarëve dhe atë të mallrave;
4. Mungesa e ligjit për sigurinë në komunikacionin hekurudhor;
5. Proceset e shumta gjyqësore të trashëguara nga ish-Hekurudhat e Kosovës;
6. Mos funksionimi i të gjitha linjave tjera hekurudhore brenda vendit;
7. Mos zbatimi i bazës ligjore dhe mungesa e legjislacionit sekondar në sektorin e transportit dhe lejimi i konkurrencës jolojale;
8. Në njërën anë mungesë e kuadrove profesionale si inxhinierë të komunikacionit dhe transportit dhe makinerisë, dhe staf teknik profesional, ndërsa në anën tjetër numër i madh i të punësuarve administrativ;
9. Moshë mesatare e lartë e personelit ekzekutiv, nevoja për staf të ri dhe të kualifikuar që mund të përcjell trendin e zhvillimit të reformave/zhvillimeve në sektor.

Për të gjitha problemet dhe vështirësitë e theksuara në këtë raport, pavarësisht angazhimit e përkushtimit të Ndërmarrjes, do të jetë e vështirë që këto të tejkalohen pa mbështetje edhe nga institucionet dhe faktorët tjerë relevantë. Në gjendjen ekzistuese është e domosdoshme kjo mbështetje që HK-Trainkos Sh.A të vendoset në rrugën e zhvillimit dhe të arrijë atë nivel të funksionimit në saje të veprimtarisë së vet.

Fushë Kosovë,
Prill 2024

Agron Statovci
U. D. Kryeshf Ekzekutiv

